



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 132

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1268 Prot., datë 2.3.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me kryetar z. Gjovalin Shqalshi

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Personat me Aftësi të Kufizuar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Gjovalin Shqalshi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3.2023 Nr: 132
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 1.3.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me initiale “PPAK”, me Kryetar z. Gjovalin Shqalshi rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar” me shkronja nistore “PPAK”, me adresë, Rruga “Don Bosko” (Muzakët), Kulla 5, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Gjovalin Shqalshi, me adresë Lagjia nr. 2, Laç, Kurbin;
- c) Financieri i partisë është znj. Luke Tuci, me adresë Rruga “Don Bosko” (Muzakët), Kulla 5, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Genci Tepelena, me adresë Rruga “Don Bosko” (Muzakët), Kulla 5, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenet 64, pika 2 dhe 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me kryetar z. Gjovalin Shqalshi, me shkronjat nistore “PPAK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

